



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr 1092/Prot.  
2

Gjirokastër, më 08/09 2020

RREGULLORE E BRENDSHME

E SENATIT AKADEMIK

Gjirokastër, 2020

(Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 26, datë 08.09.2020)



**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME**

**Neni 1**

**Objekti i rregullores**

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin, zhvillimin, vendimmarrjen dhe shpalljen e vendimeve të Senatit Akademik, në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligji Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë .

**Neni 3**

**Misioni i Senatit Akademik**

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, është organi kolegjial vendimmarrës më i lartë. Kryetar i Senatit Akademik është Rektori.

Senati Akademik përcakton politikat e zhvillimit të Universitetit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, të veprimtarisë administrative - financiare dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

Senati Akademik mban qëndrim ndaj çdo problemi të shqyrtuar, nëpërmjet vendimeve që merr.

**Neni 4**

**Përbërja e Senatit Akademik**

Senati Akademik i UGJ-së përbëhet nga 21 anëtarë, të ndarë sipas skemës në vijim:

- a. **Rektori** i zgjedhur, i cili drejton Senatin Akademik sipas përcaktimeve të nenit 39, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë";
- b. **Tetëmbëdhjetë përfaqësues** të personelit akademik, sipas përcaktimeve të nenit 37, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë", si dhe përcaktimeve të Statutit



të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, neni 13. Shpërndarja e përfaqësuesve të personelit akademik sipas njësive kryesore është si vijon:

- b.1. *Nëntë përfaqësues* për FESHSH;
- b.2. *Pesë përfaqësues* për FSHN;
- b.3. *Katër përfaqësues* për FE;
- c. **Dy përfaqësues** të studentëve, të zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, si dhe përcaktimeve të Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, neni 13.

## **Neni 5**

### **Mandati i anëtarit të Senatit Akademik**

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik fillon nga momenti i konstituimit të Senatit Akademik dhe zgjat deri në përfundim të mandatit.
2. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik konsiderohet i përfunduar në mënyrë të parakohshme në rastet kur anëtari:
  - a. jep dorëheqjen si anëtar i Senatit Akademik;
  - b. përfundon/ndërpret marrëdhënien e punës me Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, apo përfundon/ndërpret studimet në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;
  - c. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrijë funksionin;
  - d. nuk merr pjesë pa arsye në gjashtë mbledhje radhazi të Senatit Akademik;
  - e. dënohet për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - f. ndërron jetë;

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Senatin Akademik. Në rastet kur kandidatët e renditur kanë numër të barabartë votash, përzgjidhja bëhet me short. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të zgjedhur të Senatit Akademik në trupën përkatëse zgjedhore të UGJ-së (personel akademik i njësisë kryesore ose studentët me kohë të plotë studimi në universitet) që përfaqësonte anëtari pararendës.

## **KREU II**

### **VEPRIMTARIA E SENATIT AKADEMIK**

## **Neni 6**



## Funksionet kryesore të Senatit Akademik

Senati Akademik i UGJ-së ushtron këto funksione:

1. garanton lirinë akademike të UGJ-së, si dhe të drejtat e studentëve;
2. i propozon Bordit të Administrimit planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
3. miraton statutin e UGJ-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
4. miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të tij;
5. zgjedh nënkryetarin e Senatit Akademik;
6. miraton komisionet e përhershme brenda tij sipas fushave prioritare;
7. miraton rregulloret e institucionit, përveç atyre që janë kompetencë e Bordit të Administrimit;
8. miraton marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e UGJ-së në organizma apo institucione kombëtare/ndërkombëtare;
9. miraton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
10. miraton procedurat për punësimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik;
11. i propozon Bordit të Administrimit buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
12. miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
13. miraton numrin e studentëve për çdo program studimi;
14. miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi;
15. propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
16. miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
17. miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
18. miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
19. zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;



20. miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
21. garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë;
22. miraton mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
23. krijon Komisionin e përhershëm për promovimin e personelit akademik, për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, kur institucioni plotëson kriteret ligjore, si edhe komisionet e tjera të përcaktuara në statut;
24. organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare;
25. akordon tituj honorifikë sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Modalitetet e ushtrimit të këtij funksioni do të bëhen në akte të tjera të brendshme të UGJ-së;
26. zgjedh me shumicë të thjeshtë votash anëtarët e Këshillit të Etikës;
27. Senati Akademik vendos për publikimin ose jo të vendimeve të marra prej tij;

#### Neni 7

#### **Mbledhja e parë e Senatit Akademik**

1. Mbledhja e parë e mandatit të ri të Senatit Akademik thirret nga rektori i UGJ-së.
2. Në këtë mbledhje:
  - a. bëhet konstituimi i Senatit të ri Akademik sipas rezultatit të zgjedhjeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër;
  - b. miratohet rregullorja e brendshme e Senatit Akademik;
  - c. me propozim të kryetarit të Senatit Akademik zgjidhet nënkryetari i Senatit Akademik, nga radhët e anëtarësisë së senatit, me eksperiencë drejtuese të trupës akademike;
  - d. me propozim të kryetarit të Senatit Akademik përcaktohen komisionet e përhershme;
  - e. veç komisioneve të përhershme, Senati Akademik i UGJ-së mund të ngrëjë komisione të veçanta, të cilave u cakton detyra për mbledhje e përpunim informacioni, studim të dhënash, propozime konkrete për probleme të veçanta, etj;
  - f. përbërja, të drejtat, detyrat dhe funksionimi i komisioneve të përhershme dhe të veçanta, përcaktohen në rregulloren e komisioneve përkatëse, të miratuara nga Senati Akademik;



## Neni 8

### Thirrja e mbledhjes së Senatit Akademik

Senati Akademik i UGJ-së mblidhet me nismën e kryetarit të tij. Ai zhvillon mbledhje në seanca të parashikuara, si rregull një herë në muaj. Mbledhja drejtohet nga kryetari i Senatit Akademik. Në rast mungese, për arsye objektive, të kryetarit të Senatit Akademik mbledhja thirret dhe drejtohet nga nënkryetari. Në rast mungese edhe të këtij të fundit, për arsye objektive, mbledhjen e thërret dhe e drejton njëri nga anëtarët e Senatit Akademik, i deleguar me shkrim prej kryetarit.

Si rregull, seancat e Senatit Akademik nuk janë të hapura. Përrjashtohen rastet, kur është e nevojshme të ftohen të tjerë që ndihmojnë në trajtimin e çështjeve të veçanta.

Në Senatin Akademik mund të ftohen: administratori i UGJ-së, zëvendësrektorët, drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë të UGJ-së (kur nuk janë anëtarë të Senatit Akademik) si dhe të tjerë, personel akademik, ndihmës akademik apo administrative, në funksion të sjelljes së informacioneve apo vlerësime me interes, për çështjet që diskutohen. Ftesa mund të bëhet me nismën e çdo anëtari të Senatit Akademik, të miratuar paraprakisht nga kryetari i Senatit Akademik.

## Neni 9

### Seancat e jashtëzakonshme

Senati Akademik mund të thirret në seanca të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Kërkesa i drejtohet me shkrim kryetarit të Senatit Akademik, ku paraqitet në mënyrë të përmbledhur çështja që propozohet të diskutohet. Kjo mbledhje nuk mund të zhvillohet më parë se një javë nga dita e njoftimit të kryetarit të Senatit Akademik, por jo më vonë se tri javë nga kjo ditë.

## Neni 10

### E drejta e fjalës së anëtarit të Senatit Akademik

Në përputhje me temën dhe numrin e çështjeve të rendit të ditës, çdo anëtar i Senatit Akademik ka të drejtën e fjalës deri në pesë minuta për çdo çështje. Të drejtën për të folur e jep kryetari i seancës sipas radhës së kërkesës.

E drejta e posaçme e fjalës i jepet 1-2 minuta edhe në fund të mbledhjes (në çështje të ndryshme), kur gjykohet se gjatë diskutimeve të çështjeve një diskutues është sulmuar pa të drejtë ose i është deformuar ideja.



E drejta e ndërhyrjes deri në një minutë mund të jepet në fund të çdo çështjeje, kur ajo kërkohet për të bërë vërejtje të karakterit teknik, para se çështja të kalohet në votim.

Çdo kërkesë për tejkalim afatesh të parashikuara më lart duhet të miratohet paraprakisht nga kryetari i seancës. Çdo shkelje e së drejtës së fjalës nga anëtarët ndëshkohet nga kryetari i seancës me qortim, me paralajmërim për përjashtim nga seanca, me përjashtim nga seanca, shoqëruar edhe me prerje të shpërblimit të mbledhjes në masën nga 50%-100%.

#### **Neni 11**

##### **Sekretariati teknik i Senatit Akademik**

Organizimi i mbledhjeve të Senatit Akademik bëhet nga sekretariati teknik, i përbërë nga një sekretar administrativ (asistenti/ja e Rektorit) dhe juristi i institucionit.

Sekretariati teknik i Senatit Akademik të UGJ-së, ka për detyrë:

- a. hartimin e dokumentacionit të nevojshëm përkatës (njoftime, relacione, vendime etj.);
- b. regjistrin e përgjithshëm të hyrjes dhe daljes se korrespondencës/dosjeve;
- c. zbardhjen dhe regjistrimin e vendimeve të Senatit Akademik;
- d. regjistrimin e arkivimit të dokumentacionit të prodhuar nga Senati Akademik;
- e. detyra të tjera që i ngarkohen nga kryetari i Senatit Akademik;

#### **Neni 12**

##### **Data e mbledhjes dhe rendi i ditës**

Data e mbledhjes dhe rendi i ditës caktohet/miratohet nga kryetari i Senatit Akademik.

#### **Neni 13**

##### **Njoftimi i rendit të ditës, përcjellja e materialeve dhe prezantimi i tyre**

Njoftimi i rendit të ditës dhe përcjellja e materialeve bëhet nga sekretari administrativ me mesazh elektronik (e-mail) ose me shkrim, jo më vonë se një ditë para datës së mbledhjes, i protokolluar në përputhje me rregulloren e brendshme për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit. Bëjnë përjashtime rastet urgjente kur nuk pret koha për zbatimin e procedurës sipas këtij rregulli. Në rastet e mosnjoftimeve të qëllimshme të anëtarëve të Senatit Akademik, personi/personat shkaktar mban/mbajnë përgjegjësi sipas akteve normative në fuqi. ~~Përgatitja e dosjeve me materialet përkatëse të rendit të ditës përgatiten nga Sekretariati teknik.~~

Çështjet e trajtuara me material të shkruar nga kryetari i Senatit Akademik, senatorë, grup senatorësh apo persona e grup personash jashtë Senatit Akademik, depozitohen në afatin e duhur dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të Senatit Akademik. Për efekt kohe ~~apo për urgjencë~~



çështjes që diskutohet, materiali i shkruar mund të lexohet në mbledhje, jo i plotë, por i përmbledhur. Referuesi, pas diskutimeve, ka në dispozicion deri në 5 minuta për të bërë sqarimet apo saktësimet e duhura, veç kohës, që i duhet për përgjigje ndaj pyetjeve të bëra.

Kur diskutohet buxheti apo çështje financiare e administrative që shprehen në shifra e skema, materiali duhet të jetë patjetër i shkruar dhe i disponueshëm për anëtarët e Senatit Akademik.

#### **Neni 14**

##### **Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës miratohet në fillim të mbledhjes nga Senati Akademik. Çdo kërkesë për futjen në rend të ditës të çështjeve të tjera duhet t'i paraqitet kryetarit të paktën një javë përpara mbledhjes. Në raste të veçanta, kryetari i Senatit Akademik apo  $\frac{1}{4}$  e anëtarëve të Senatit Akademik mund të propozojnë vendosjen në rend të ditës të një çështjeje të paregjistruar më parë.

#### **Neni 15**

##### **Kuorumi i mbledhjeve të Senatit Akademik**

Mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet kur në të marrin pjesë të paktën 50% + 1 (një) të e numurit të përgjithshëm të anëtarëve të tij. Duke qënë se 50% e anëtarësisë rezulton numur me shifër 5 (pesë) pas presjes dhjetore, rrumbullakimi orjentohet drejt numurit më të madh.

Në rast se nuk plotësohet ky kuorum, mbledhja shtyhet për një datë jo më vonë se pas një jave. Në rast se edhe në mbledhjen e dytë nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm, mbledhja shtyhet për një datë tjetër jo më vonë se pas një jave nga data e caktuar për zhvillimin e mbledhjes së dytë. Në këtë mbledhje të tretë kuorumi vlerësohet i pranueshëm, pavarësisht nga numri i anëtarëve.

Në fillim të mbledhjes, sekretari administrativ, me kërkesën e kryetarit të Senatit Akademik, relatton për prezencën dhe mungesat e anëtarëve të Senatit Akademik, duke dhënë shpjegimet e nevojshme.

#### **Neni 16**

##### **Procesverbalet e mbledhjeve të Senatit Akademik**

Procesverbalet e mbledhjeve të Senatit Akademik mbahen nga sekretari administrativ dhe firmosen nga ai dhe nga kryetari i Senatit Akademik. Zbardhja e procesverbaletëve bëhet jo më vonë se 10 ditë pas mbledhjes.





## Neni 17

### Relacionet e Senatit Akademik

Për çështje shumë të rëndësishme të diskutuara në mbledhjet e Senatit Akademik mund të përpilohen relacione mbi përfundimet e arritura gjatë diskutimit të tyre, të cilat u përcillen anëtarëve të Senatit Akademik. Brenda 10 ditëve, pasi janë reflektuar vërejtjet apo sugjerimet e anëtarëve të Senatit Akademik, relacioni i përcillet strukturave të institucionit (njësi kryesore, njësi bazë, njësi ndihmësakadematike dhe njësi administrative), sipas përcaktimeve të Senatit Akademik.

## Neni 18

### Shpërblimi i anëtarëve të Senatit Akademik

Anëtarët e Senatit Akademik si dhe Sekretariati teknik shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhje në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

## KREU III

### ZBARDHJA, NËNSHKRIMI DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË SENATIT AKADEMIK

## Neni 19

### Votimi

Procedura më e zakonshme për marrjen e vendimeve apo miratimin e akteve të tjera të Senatit Akademik është mirëkuptimi dhe votimi i hapur.

Në raste të veçanta votimi bëhet i fshehtë. E drejta e votës ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk është e delegueshme.

Vendimet e Senatit Akademik merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, veç rasteve që parashikohen ndryshe në akte normative.

Në rastin e votimeve nominale, të klasifikimit të punonjësve dhe për çështje të tjera (kur kjo kërkohet nga kryetari ose nga  $\frac{1}{2}$  (një e dyta) e të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik), vendimet merren me shumicë absolute (50% + 1 e të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik të UGJ-së). Duke qënë se 50% e të gjithë anëtarëve rezulton numur me shifër 5 (pesë) pas presjes dhjetore, rumbullakimi orjentohet drejt numurit më të madh.

## Neni 20

Nënshkrimi, shprehja dhe veprimi i akteve të miratuara nga Senati Akademik




Vendimet dhe çdo dokument tjetër i miratuar nga Senati Akademik firmosen nga kryetari në emër të Senatit Akademik.

Vendimet e Senatit Akademik të UGJ-së shprehen me shkrim dhe u dërgohen zëvendësrektorëve, administratorit të UGJ-së, dekanëve, drejtuesve të njësive bazë, si dhe strukturave të tjera (sipas përmbajtjes së vendimit). Ato janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha njësitë përkatëse.

Vendimet e Senatit Akademik, si rregull, hyjnë në fuqi menjëherë. Në raste të veçanta Senati Akademik mund të përcaktojë me miratim kohën e hyrjes në fuqi të vendimit përkatës.

Vendimet e Senatit Akademik publikohen në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.

Prof.dr Bektash MEMA  
  
KRYETARI SENATIT AKADEMIK

